

E diel, 17 nëntor 2019 - Shenjtori i ditës



Oshënar Grigori i Neoqesarisë. Oshënar Genadi i Konstandinopojës. Oshënare Hilda.

– Oshënar Grigori i Neoqesarisë –

Ati ynë i shenjtë Grigori lindi rreth vitit 214, në gjirin e një familjeje të ndritur pagane të Neoqesarisë, në Pont. E ëma e Grigorit, e vetmja përgjegjëse për kujdesin e tre fëmijëve të saj pas vdekjes së të shoqit, përpigjej t'u jepte një edukim të shëndoshë. Grigori, i cili atëherë quhej Theodhor, jo vetëm që tregoi dhunti të mëdha për studim dhe në veçanti për retorikën, por edhe mençuri të thellë dhe butësi të madhe.

Që nga mosha 14-vjeçare iu largua lojërave turbulluese të shokëve të tij, për t'u dhënë në soditjen e harmonisë së krijesës dhe duke shprehur mendime rreth

ekzistencës së një Krijuesi të vetëm. Besimi i krishterë ishte pothuaj i panjohur në atë krahinë: në Neoqesari numëroheshin gjithsej vetëm 17 të krishterë. Shokët e tij, xhelozë për jetën e shenjtë dhe të pastër që bënte Grigori, paguan një ditë një prostitutë, që të hapte fjalë te njerëzit se Theodhori kishte rënë në shthurje me të. Kur i dëgjoi këto shpifje, i riu nuk kërkoi të justifikohet, as nuk u zemërua kundër tyre, por preferoi t'i jepte po aq para sa kishte marrë gruaja e përdalë për gënjeshtrat, që ta linte të qetë.

E ëma kishte vendosur t'i dërgonte të dy bijtë, Theodhorin dhe Athinodhorin, vëllanë e tij, të studionin për drejtësi në shkollën e famshme të Beritës (Bejrutit), por u kërkoi ta çonin më përpara motrën e tyre në Qesari të Palestinës, te bashkëshorti i saj. Atje vëllezërit njohën Origjenin e madh dhe, duke lënë pas çdo plan tjetër, ndoqën me etje mësimet e tij për 8 vjet. Ata u futën në theologjinë e krishterë nga mësuesi aleksandrin, por patën mjaftueshëm dallueshmëri që të mos binin në disa gabime të tij, të cilat erdhën si pasojë e disa spekulimeve tepër të guximshme për misteret hyjnore.

Kur u kthye në atdhe, shumë të pasur u turrën pas Grigorit, duke i propozuar privilegje për t'u bërë këshilltar i fëmijëve të tyre. Por i riu i hodhi poshtë tërë tërheqjet mashtruese të botës, për të shkuar në shkretëtirë, që të jetonte i vetëm para Perëndisë, në lutje dhe asketizëm. Kryepiskopi i Amasisë, Fajdimi, i cili kishte dëgjuar të flitej për virtytet e Grigorit dhe për dhuratat e tij në artin oratorik, u përpoq ta bindte të vinte në mitropoli, që ta hirotoniste episkop të Neoqesarisë. Por Grigori s'pranoi të linte shkretëtirën e tij e të kthehej në turbullimet e botës. Fajdimi bëri atëherë diçka të pazakontë të cilën e mundësoi vetëm sistemi kanonik jo i formuar mirë i një Kise ende të re, e hirotonisi Grigorin në distancë, pa i vënë duart drejtpërdrejt, dhe i dërgoi një letër në të cilën vërtetonte se, donte apo jo, ai ishte zgjedhur tashmë episkop i qytetit të tij. Grigori ishte rreth 30 vjeç dhe iu bind vullnetit të Perëndisë, por nuk e braktisi shkretëtirën, ku kishte kaluar shumë ditë e net në lutje, që Perëndia ta forconte në veprën e tij baritore.

Një natë, e Tërëshenjta dhe shën Joan Theologu iu shfaqën dhe i zbuluan qartazi misterin e unitetit të natyrës hyjnore dhe të dallimit midis tre Personave, me këto fjalë: "Ai është një Perëndi i vetëm, Atë i Fjalës së gjallë, i Urtësisë ekzistuese, i Fuqisë dhe i Vulës së përjetshme. Ai është Ati i përsosur i Birit të përsosur. Ka vetëm një Zot, i Vetëm prej të Vetmi, Perëndi prej Perëndie, vula dhe ikona e Hyjnisë, Fjalë e vërtetë.

Biri i vërtetë i Atit të vërtetë, i padukur prej të padukuri, i përjetshëm prej të Përjetshmi.

Dhe ka një Shpirt të Shenjtë që buron prej Perëndisë (Atë) dhe vjen nëpërmjet Birit.

Ai është shkaku i jetës, burim i shenjtë dhe burim shenjtërimi. Në të dëftehet Perëndia Atë, që është mbi gjithçka dhe në çdo gjë, dhe Perëndia Bir, që është përtej çdo gjëje.

Trini e përsosur. Në Trini nuk ka asgjë të krijuar, as skllavëri, as diçka që do të kishte qenë më përpara, dhe që do të ishte futur më pas. Kështu, as Biri nuk i ka munguar Atit, as Shpirti Birit.”

I fuqizuar nga Shpirti i Shenjtë, ai u bë i denjë, si një Moisi tjetër, të merrte zbulimin e Mistereve drejtpërdrejt nga Perëndia. Grigori u tregua apostull i palodhur i besimit të vërtetë në tërë krahinën e Neoqesarisë. Kthente shumë si me fjalën, ashtu edhe me mrekullitë: dëshmi shpërthyes se fuqia e Perëndisë ishte me të dhe jo me demonët e pafuqishëm të paganëve; ndaj edhe mori epitelin Çudibërës.

Më 250, gjatë persekutimit të egër të Deciusit, Grigori me një numër të madh besimtarësh preferuan më shumë të largoheshin nëpër malet afër Neoqesarisë, sesa të jepeshin kot në vdekje. Në realitet, sa për vete, ai tashmë kishte vdekur prej kohësh për botën, si apostull Pavli (Fil. 1.24), por dashuria për grigjën e tij dhe merakun për të ruajtur Kishën, duke fuqizuar besimin e më të dobtëve, e kishte bindur për largimin. Në vendin ku u vendosën, ai lutej për martirët që dhanë gjakun dhe u përshkruante shokëve të vet betejat e tyre, sikur t'i kishte para syve. Në fund të persekutimit, u mbledhi lipsanet dhe porositi të kremtoheshin festa të mëdha për nder të tyre në të njëjtat ditë kur paganët e kishin zakon të shkonin në festimet e tyre, në mënyrë që e gjithë krahina të bëhej rrënjësisht e krishterë dhe shumë shpejt, zakonet e saj pagane u shndërruan në dëfrime shpirtërore.

Grigori vazhdoi të shkëlqente me çuditë e tij dhe me predikimin e besës orthodhokse për shumë vjet. Rreth vitit 275, disa ditë para se të nisej në qiej, u kërkoi të afërmve se sa paganë kishin mbetur në dioqezë. Mësoi se nuk ishin më shumë se 17, pikërisht i njëjti numër si ai i të krishterëve kur mori detyrën. Kështu fjeti me paqen dhe me gëzimin e shërbëtorit, që kreu besnikërisht detyrën që i ngarkoi Zoti i tij.

* * * * *

– Oshënar Genadi i Konstandinopojës –

Shën Genadi ishte prift në Kishën e Konstandinopojës. Më 458, pas vdekjes së patriarkut Anatol (3 korrik), u zgjodh në fronin patriarkal, për shkak të përkushtimit dhe integritetit të sjelljeve.

U tregua ruajtës mjaft besnik i traditave apostolike dhe e drejtoi grigjën e tij shpirtërore me urtësi të madhe baritore. Vuri rregulla te kleri i prishur nga simonia

(tregti me pushtetin fetar), caktoi pushim të detyrueshëm për të dielat dhe ruajti harmoninë e marrëdhënieve të Kishës me pushtetin civil. Mbrojti me zell besimin orthodhoks dhe përdori ndikimin e tij pranë perandorit për të dënuar patriarkun heretik të Antiokisë, Petro Fuloni. Shkëlqeu me shumë mrekulli që Perëndia i dha të bënte për përforcimin e Kishës. Një ditë, ai paralizoi dorën e një ikonografi, që kishte paraqitur Krishtin në formën e perëndisë pagan, Zeus.

Tregohet se në fund të jetës, duke mos dashur të drejtonte Kishën e nënshtroar ndaj perandorit heretik (Leoni I 457-474), shën Genadi dha dorëheqjen dhe u nis në pelegrinazh për në Vendet e Shenjta, i veshur si murg i thjeshtë. Në kthim, ndaloi në Qipro që të nderonte vendet e shenjtëruara nga shën Ilarioni (21 tetor). Por gjatë rrugës, humbi dhe arriti në një qytezë me emrin Kisopetra. Një stuhi bore e bllokoi dhe shkoi e trokiti në derën e një vejushe, e cila nuk denjoi ta pranonte këtë të huaj dhe të nesërmen patriarkun e shenjtë e gjetën të vdekur nga të ftohtët në pragun e derës.

SHĚN GENADI
I KONSTANDINOPOJĚS



SHĚN GRIGORI
I NEOQESARISĚ



ΧΕΙΡ. Π. ΚΟΙΝΟΥ
ΣΑΝΚ

— facebook.com/koash1991